



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4**

Nr. 173/5 prot

Tiranë më 28.02.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Ne zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" : të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të Vazhduar profesional të personelit" , mbështetur në Udhëzimin e përbashkët nr. 3 datë 13.12.2024 " Për marrjen në punë të punonjësve me kohë të pjesshe, në qendrat e formimit profesional publik dhe shkollat e mesme profesionale" ,
QFPP Nr.4, ju njofton krijimin e vendit të lirë të punës për pozicionin instruktor me kohë të pjesshme :

- 1. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Parukeri, Estetikë, Manikyr Pedikyr---- 2 Persona**
- 2. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Instalime dhe Mirembajtje e rrjetit elektrik , Riparime Elektroshtëpiake , Riparime për paisjet audio dhe televizive ----2 Persona**
- 3. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Instalim dhe mirembajtje hidraulike , ----2 Persona**
- 4. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Kuzhinë ----- 1 Persona**
- 5. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Aftësi për Punësim , Kujdestari për të Moshuar -----1 Person**

6. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Punime Ndërtimi / Bojatisje / Punime muratimi suvatimi / Punime Pllakashtrimi / Administrator Ndërtesash / Hekurkthim / Sisteme të thata në ndërtesa ----- 1 Person
7. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Termohidraulik, Instalim dhe mirëmbajtje e sistemeve ngrohëse ftohëse , Instalim dhe mirëmbajtje e paneleve diellore ----- 1 Person
8. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Grafik dizajn, Ëeb dizajn , Aftësi digjitale , Riparim Kompjuteri ----- 2 Persona
9. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Gjuhë e huaj Gjermanisht----- 1 Person
10. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Udhërrëfim Turistik ----- 1 Person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a. letërmotivimin për pozicioni;
- b. jetëshkrimin (CV në);
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;

- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
- j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- k. të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFPsë, brenda datës ...

10.03.2025

Duke ju falenderuar për mirekuptimin

DREJTOR

Valbona Hoxha



